


Statistikat Tregtare të Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Holandë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), bilanci tregtar me Holandë¹, për vitin 2025, ka shënuar një përmirësim prej 21.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke u zvogëluar në -27.1 milionë euro nga -34.4 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti është rreth 51.4%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Holandë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	29.1	27.2	25.3	28.6
Import	48.6	45.8	59.7	55.7
Bilanci tregtar	(19.5)	(18.6)	(34.4)	(27.1)
% e mbulimit	59.9%	59.3%	42.3%	51.4%
Rritje Exp. (v-m-v) %	41.7%	-6.5%	-7.1%	13.3%
Rritje Imp. (v-m-v) %	-4.7%	-5.6%	30.2%	-6.7%
Bila. Treg. (v-m-v) %	-36.0%	-4.3%	84.7%	-21.4%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


¹ Holanda, zyrtarisht Mbretëria e Vendeve të Ulëta, është një vend në Evropën Veriperëndimore, me kryeqytet Amsterdamin. Ka një sipërfaqe prej 41,865 km², me rreth 18.1 milionë banorë. Bruto prodhimi vendor (GDP) nominal për vitin 2025 vlerësohet rreth 1.33 trilion \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 73,833 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 18-të sipas FMN-së.

Analizuar në periudhën e fundit marrëdhëniet tregtare të mallrave ndërmjet Kosovës dhe Holandës karakterizohen nga një deficit i vazhdueshëm tregtar gjatë periudhës 2022–2025.

Gjatë kësaj periudhe Eksportet e Kosovës me Holandë kanë një trend përafërt nga rreth 29.1 milionë euro në vitin 2022, në 27.2 milionë euro (në 2023), në 25.3 milionë euro (në 2024) deri 28.6 milionë euro në vitin 2025.

Te Importet vërejmë luhatje, nga një pikë prej 48.6 milionë euro (në 2022), në 45.8 milionë euro (në 2023), ngritje e ndjeshme me 30.2%, në 59.7 milionë euro (në 2024) dhe rënie e lehtë në vitin 2025, në 55.7 milionë euro.

Figura 2. Eksport/Importi me Holandë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në Holandë, shënoi rritje për 13.3% krahasuar me vitin paraprak, dhe arritën në 28.6 milionë Euro apo 3.0% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, renditet e 8-ta në listën e vendeve kryesore të eksportit.


Importi i mallrave nga Holanda arriti në 55.7 milionë euro apo 0.8% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm.

Struktura e Eksportit/Importit me Holandë në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesore të Eksportit e përbëjnë: 34.6% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 30.8% Metalet bazë dhe

artikujt prej tyre; 18.0% Produkte bimore; 4.1% Ushqime të përg. pije, pije alkoolike dhe duhan; 3.9% Produkte të industrisë kimike; 2.4% Artikuj të ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj), etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Holandë.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)


Rritja e eksporteve për 13.3% apo rreth 3.4 milionë euro më shumë mallra në tregun holandez në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja te sektorët si Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre (nga 11.5% në 34.6%) dhe te Produkte bimore (nga 17.1% në 18.0%).

Eksportet e Kosovës drejt Holandës karakterizohen me luhatje nëpër vite mes sektorëve, me një përqendrim i lartë te disa sektorët kryesorë (metale bazë, plastikë, dhe produkte bimore) përbëjnë rreth 68.6% në vitin 2024, ndërsa në vitin 2025 rreth 83.4% në të vlerës totale të eksportuar janë nga sektorë (plastikë, metale bazë dhe produkte bimore).

Transformimi i strukturës së eksportit në vitin 2025, me një rritje të madhe te sektorit të artikujve të prodhuar, plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre nga 11.5% në vitin 2024 në 34.6% në vitin 2025, dëshmon për një zhvendosje pozitive drejt produkteve me vlerë më të lartë të shtuar krahasuar me lëndët e para minerale të vitit paraprak.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 23.1% Ushqime të përg. pije, pije alkoolike dhe duhan; 17.0% Produkte bimore; 15.7% Produkte të industrisë kimike; 14.8% Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe; 6.5% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 5.5% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 4.8% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 2.8% Mjetet e transportit etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Holanda.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rënia e importeve për 6.7% apo rreth 4.0 milionë euro më pak mallra te importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia e sektorëve si Ushqime të përg. pije, pije alkoolike dhe duhan, Produkte bimore dhe Produkte të industrisë kimike.

Dominimi i ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit dhe Produkteve bimore me rreth 38.1% vitin 2024 dhe rreth 40.1% në vitin 2025 të vlerës totale në strukturën e importeve, tregon rëndësinë e theksuar të tregut të konsumit kosovar për këto prodhime holandeze.

Kjo paraqet një mundësi për zëvendësim përmes investimeve në industrinë vendore të përpunimit të ushqimit dhe mundësinë për të hartuar e zbatuar politika zhvillimore në drejtim të rritjes së prodhimit vendor dhe uljen e varësinë nga produktet e importuara.